

RAPORT MONITORIMI  
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT  
TË KOMITETIT SHQIPTAR TË  
BIRËSIMEVË  
**JANAR –DHJETOR 2023**

- ✓ **Përmbledhje Ekzekutive**
- ✓ **Qasja vlerësuese**
- ✓ **Metodologjia e monitorimit**
- ✓ **Gjetjet e raportit**
- ✓ **Objektivat e parashikuar ne Planin e Integritetit**
- ✓ **Konkluzione dhe rekomandime**
- ✓ **Hapa të tjera**

KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
MD	Ministria e Drejtësisë
MVRI	Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Integritetit
PI	Plan Integriteti
PT	Programi i Transparencës
SNKK	Strategjia Ndërsektorale kundër Korrupsionit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Përballja efektive me korrupsionin për Komitetin Shqiptar të Birësimeve është tepër e rëndësishme për arritjen e rezultateve të larta në forcimin e integritetit institucional, mirëqeverisjen, si dhe ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Duke qënë se Komiteti Shqiptar i Birësimeve është autoriteti qendror në fushën e birësimit, vendas dhe ndërvendas kemi një rol të rëndësishëm në këtë fushë dhe jemi të vetëdijshëm se duhet të jemi ndër të parët që të japim shembullin për t'i shërbyer interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Plani i integritetit është shprehje konkrete e vullnetit dhe përkushtimit për integritet institucional, si edhe e qëndrimit proaktiv për të mbështetur përpjekjet dhe reformat antikorrupsion.

Në kontekstin e sektorit publik, integriteti konsiston në përmbushjen e detyrimeve të: transparencës, llogaridhënies, etikës, ndershmërisë, efektivitetit dhe efikasitetit në përmbushjen e detyrave dhe të ushtrimit të funksioneve rregullatore dhe administrative. Vendosja e planit të integritetit dhe sigurimi i zbatimit të tij përbën një qasje që garanton masat antikorrupsion dhe një mundësi të shtuar të suksesit të zbatimit të tyre.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve, është kontribuese për objektivat A.8 dhe A.9 të SNKK-së, që materializojnë forcimin e integritetit në administratën publike.

Në zbatim të këtyre objektivëve, gjatë vitit 2021, Komiteti Shqiptar i Birësimeve hartoi dhe miratoi Planin e Integritetit i cili ka karakter parandalues në luftën kundër korrupsionit. Ky plan është hartuar duke u mbështetur në Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit (MVRI) për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr.334, datë 07.10.2021.

Plani i Integritetit i Komitetit Shqiptar i Birësimeve është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuar në 5 fusha të përgjegjësisë institucionale të KSHB-së ku përfshijnë: menaxhimin e burimeve njerëzore; kontrollin, auditimin dhe mekanizmat kundër korrupsionit; transparencën. Plani i Integritetit përmban gjithsej 12 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete)

përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë stafi i Komitetit Shqiptar i Birësimeve. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2024.

Referuar miratimit të Instrumentit të Monitorimit të Planit të Integritetit në Institucionet e Qeverisjes Qendrore, nga Ministria e Drejtësisë, Komitetit Shqiptar i Birësimeve ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të Komitetit Shqiptar i Birësimeve, për vitin 2023, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, përmban të dhëna për veprimtarinë operationale të stafit të brendshëm kontribues, referuar hartimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm , burimeve njerëzore dhe profesionale si dhe transparencën dhe komunikimin me grupet e interesuara.

*Për vitin 2023, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 7 masa/aktivitete, të shpërndara në 3 objektiva, përkatësisht:*

1. Rritja e efektivitetit në menaxhimin e burimeve njerëzore;
2. Forcimi i kuadrit të brendshëm rregullator dhe mekanizmave të kontrollit;
3. Garantimi i transparencës më të lartë të punës dhe veprimtarisë së KSHB-së brenda institucionit dhe me publikun.

Këto objektiva strategjike bazohen dhe përputhen me parimet e menaxhimit të riskut të integritetit të MVRI, me vizionin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, si edhe me paketën e legjislacionit në fushën e anti-korrupsionit, parandalimit të konfliktit të interesit dhe transparencës në sektorin publik. Këto objektiva i kanë shërbyer punës së institucionit përgjatë periudhës së parashikuar, duke angazhuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha strukturat dhe nëpunësit përgjegjës.

Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 3 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për vitin 2023, rezulton se: janë zbatuar 3 masa/aktivitete të parashikuara.

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit në publikimin dhe njoftimin e kuadrit ligjor, konsultimin publik, raporteve të performancës dhe ato të menaxhimit.

## ■ Qasja vlerësuese

---

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Komitetit Shqiptar i Birësimeve përmban një analizë të përgjithshme të kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit në KSHB-së, të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

## ■ Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të Stafit të Komiteti Shqiptar i Birësimeve dhe të koordinatorit të së drejtës së informimit, një funksion i përcaktuar në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit.

## Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinatori i Planit të Integritetit të Komitetit Shqiptar të Birësimeve, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinatori i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme.

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit kontribuues në këtë raport, i cili përfshin të gjithë stafin e Komitetit Shqiptar të Birësimeve.

1. Referuar objektivave për vitin 2023 në fushën e **Menaxhimit të burimeve njerëzore** janë realizuar aktivitetet e parashikuara:

Evidentimi i vazhdueshëm i nevojave për trajnim i stafit të ri apo ekzistues. Këto nevoja janë evidentuar në vazhdimësi dhe ju janë kërkuar me email zyrtar Sektorit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Drejtësisë .

Gjithashtu, për nevojat që ka pasur stafi në lidhje me prokurimet publike , ASPA nuk ka patur trajnime specifike për këtë fushë .

2. Në fushën e **forcimit të kuadrit të brendshëm rregullator dhe mekanizmave të kontrollit**, institucioni ynë ka ndërmarrë një sërë veprimesh dhe hapash për të siguruar zbatimin e rregullave dhe standardeve të përcaktuara. Disa nga masat që janë realizuar përfshijnë:

**Rritja e kapaciteteve profesionale:** Institucioni i Ministrisë së Drejtësisë ka investuar në trajnim dhe zhvillim të profesionistëve që merren me rregullimin dhe kontrollin e MD dhe institucioneve të vartësisë , duke siguruar njohuri dhe aftësi të nevojshme për të kryer detyrat e tyre.

**Automatizimi dhe teknologjia e informacionit:** Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe automatizimi i proceseve ka ndihmuar në rritjen e efikasitetit dhe sigurisë në monitorimin dhe zbatimin e rregullave. Janë zhvilluar sistemet si: HRMIS, AFMIS, zgjerimi i fushave që përdor sistemi e-albania, fiskalizimi i faturave online, deklaratimet e pasurive për titullarët në sistemin internal hidda të ILDKPKI.

**Auditime dhe inspektim të rregullt:** Institucionet kanë ndërmarrë masa për të kryer auditime dhe inspektime të rregullta në sektorët që janë nën mbikqyrje, duke identifikuar dhe korigjuar shkeljet në kohë. Gjatë vitit 2023 KSHB i është nënshtruar auditit të MD dhe KLSH.

**Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Institucioni ynë është përfshirë në bashkëpunim ndërkombëtar me autoritetet qendrore të huaja dhe me Agjensitë ndërmjetësuese të huaja.

Këto masa dhe hapa janë disa nga përpjekjet që janë bërë në fushën e forcimit të kuadrit të brendshëm rregullator dhe mekanizmave të kontrollit nga institucionet. Çdo vend dhe sektor mund të ketë hapat e tyre specifike në këtë drejtim.

**3. Në fushën e Transparencës** në kuadër të Programit të transparencës, janë bërë hapa të rëndësishëm përpara për zgjerimin e rrezes së transparencës ndaj publikut në aspekte të rëndësishme të operimit të punëve dhe shërbimeve të institucioneve shtetërore. Publikimi në Web-in e institucionit të materialeve raportuese dhe llogaridhënëse ndaj publikut, konkretisht:

- Regjistrat e parashikimit të prokurimeve publike;

<https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Regjister-parashikimesh-publike-i-perditesuar-19.06.2023.pdf>

- Regjistrat e realizimit të prokurimeve publike 2023.

<https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Regjister-realizimi-per-Prokurime-Publike-2023.pdf>

- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat

<https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Informacion-per-procedurat-e-prokurimit.pdf>

- E drejta për t'u informuar dhe për t'u ankuar në linkun:

<https://www.idp.al/e-drejta-per-informim> . Këtu mund të aksesohen formatet e kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

Për këtë qëllim është vënë në shërbim të publikut të gjerë informacion i detajuar për aktivitetin e përditshëm institucional të KSHB-së, në Web, në faqen online.

### **Përditësimi i informacionit në faqen Web të KSHB;**

- Publikimi i bazës ligjore mbi të cilën KSHB ushtron veprimtarinë e vet, duke bashkëlidhur dhe link përkatës ku mund të aksesohet legjislacioni.

<https://kshb.gov.al/ep-content/uploads/2023/08/Ligji-per-biresimin-i-ndryshuar.pdf>

- Janë pasqyruar struktura organizative, funksionet, organigrama, kategoritë e pagave, statistikat vjetore, aktivitetet, Raportet e Monitorimit të realizimit të Buxhetit (4-mujori i parë i vitit 2023, 8-mujori dhe 12-mujori) , Regjistri i parashikimit dhe i realizimit te



prokurimeve publike për vitin 2023, Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2023 si dhe procedurat e birësimit.

- <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2022/07/Dok.-2-i-ndryshuar.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Struktura-e-pagave-2023.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Procedurat-dhe-mekanizmat-per-te-bere-kerkese-dhe-ankese.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Regjister-realizimi-per-Prokurime-Publike-2023.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Regjister-parashikimesh-publike-i-perditesuar-19.06.2023.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/EU-format-Alma-Laci-shqip-doc-1.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Vendimarrja-e-AP.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Anekset-e-Raportit-te-Monitorimit-Maj-Gusht-2023.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2023/11/Relacion-Monitorime-8-mujori-2023-Biresime.pdf>
  - <https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/Relacion-Monitorime-12-mujori-2023-Biresime.pdf>
- [https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BPPM\\_ANEKSI\\_1-4-KSHB.pdf](https://kshb.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/BPPM_ANEKSI_1-4-KSHB.pdf)

Ky program mundëson akses të gjithanshëm dhe të përmbledhur për të gjithë aktivitetin e KSHB-së, në shërbim të publikut.

#### Konkluzione dhe Rekomandime

---

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar- dhjetor 2023*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që sektorët kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezulton se:

- Komiteti Shqiptar I Birësimeve ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit. Për vitin 2023 zbatimi I planit është në masën 100%.

- Garantimi i transparencës e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e KSHB-së për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit [www.kshb.gov.al](http://www.kshb.gov.al).

#### Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në planin e veprimit;
- Të vijohet me raportimet periodike.